

## STATUTI I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "4 AIRWAYS ALBANIA" SHPK

#### EMRI I SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

##### Neni 1 Themelimi, Emertimi

Sot, me date 17 Shtator 2024 (dymije e njezet e kater), une Elda Subashi, shtetase Shqiptare, lindur ne Elbasan, Shqiperi me 19.02.1988, mbajtes i pasaportes me nr. BF1560624 dhe i kartes se identitetit me nr I85219049U, banues ne Rruga Muhamet Gjolllesha, Pall. 1/1, Ap 24 Tirane , Shqiperi, themeloj Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emeruar si "4 Airways Albania" shpk.

##### Neni 2 Objekti

2.1 Objekti tregtar i shoqerise do te jete:

(a) Veprimtaria kryesore tregtare e kompanise eshte te kryeje sherbime si Operator Ajror per transportin e mallrave dhe pasagjereve. Aktivitetet e tjera ndihmese jane:

(b) te aplikoje dhe te zoteroje te gjitha lejet e nevojshme te vlefshme per operacionet nga autoritetet perkatese.

(c) te bleje, te marre me qira, te shkembeje, te jape me qira ose te marre nen zoterim per qellime te zhvillimit ose rishitjes çdo prone te paluajtshme apo te levizshme, per çdo lloj prone ose interesi;

(d) te marre hua ose te huazojë fonde ne menyra te pershtatshme per nevojat e biznesit, nepermjet leshimit te obligacioneve, qofte te perhershme, te rimbursueshme, te ripagueshme, ose titujve te tjere, dhe te siguroje shlyerjen e çdo borxhi te marre hua ose te ngritur permes hipotekimit, ose te drejtes se pengut mbi te gjithë ose ndonje pjese te pasurise ose asetëve te kompanise.

(e) te regjistroje, bleje, te mbaje ose te shese, vetem ne emer dhe per llogari te kompanise, çdo aksion ose letra me vlere, ose obligacionet e ndonje kompanie tjetër, dhe te investoje ose te jape hua ndonje nga parate e kompanise qe nuk jane te nevojshme menjehere per operacionet e saj, sipas menyres qe do te vendose bordi i drejtoreve;

(f) te hyje ne marreveshje me çdo qeveri ose çdo korporate, kompani, firma ose person qe mund te duket i favorshem per objektivat e kompanise, dhe te marre nga qeveri, autoritete, korporata, kompani, firma ose persona te tille çdo kontrate, grant, te drejte, privilegj dhe koncesion qe kompania mund te konsideroje te arsyeshme, dhe te kryeje, realizoje, ushtroje dhe te permbushe çdo kontrate te tille, grant, te drejte, dhe koncesion;

(g) te shese, jape me qira, hipotekoje ose ne ndonje menyre tjetër te disponoje, prona dhe asete te kompanise per ate çmim qe kompania e sheh te pershtatshme;

(h) te hyje ne partneritete ose marreveshje per ndarjen e fitimeve, bashkimin e interesave ose bashkepunimin me ndonje kompani, ose person qe kryen çdo biznes brenda objektivave te kompanise;

(i) te bashkohet me çdo partneritet, firme ose ndermarrje qe ka objektiva te ngjashem ose identike me ato te kompanise;

(j) te marre dhe ndermarre te gjithë ose ndonje pjese te biznesit dhe asetëve te çdo personi, firme ose partneriteti

qe kryen ndonje nga bizneset te cilat kompania eshte e autorizuar t'i kryeje;  
(k) te investoje dhe te tregtoje çdo aksion ose tituj pronesis ne menyren qe mund te percaktohet nga koha ne kohe, vetem ne emer dhe per llogari te kompanise;  
(l) Gjetja apo sigurimi i burimeve njerezore te domosdoshme per realizimin e aktiviteteve ne industrine e aviacionit dhe ofrimi i ketij sherbimi kompanive te tjera;

2.2 Objekti i Shoqerise mund te shtohet ose ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem.

2.3 Shoqeria mund te kryeje aktivitete te tjera se bashku me ato qe i perkasin objektit te saj, nese keto aktivitete jane te nevojshme per ekzistencen ose per veprimtarine e Shoqerise, por nuk perbejne aktivitetin e saj te zakonshem.

### **Neni 3** **Selia**

3.1 Selia ligjore e shoqerise eshte *“Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Nr. 131, 1019, Tirana, Albania.”*

3.2 Me vendimin e Asamblese se Ortakut te Vetem mund te hapen ose mbyllen ne Shqiperi ose jashte saj, njesi dytesore, dege dhe filiale.

### **Neni 4** **Baza Ligjore**

4.1 Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj ne perputhje me kete Statut dhe legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

### **Neni 5** **Kohezgjatja**

5.1 Shoqeria do te filloje aktivitetin e saj pas regjistrimit prane regjistrimit tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit (QKB).

5.2 Shoqeria krijohet me afat te pacaktuar.

### **Neni 6** **Kapitali**

6.1 Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 100 (njqind) Leke.

6.2 Kapitali i Shoqerise perbehet nga 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 100% (njqind per qind) te kapitalit te Shoqerise me vlere nominale 100 (njqind) leke dhe do te zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise, Z. Elda Subashi ("Ortaku i Vetem").

## **Neni 7**

### **Transferimi i kuotave**

7.1 Ortaku i vetem zoteron ne menyre ekskluzive kuoten e vetme te kapitalit te Shoqerise.

7.2 Kuota e kapitalit te Shoqerise mund t'i transferohet te treteve vetem permes nje marreveshjeje me shkrim.

7.3 Kuota e kapitalit te Shoqerise mund te transferohet me trashegimi pa nevojen e ndonje akti te veçante.

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres (Struktura Qeverisese)**

8.1 Asambleja e Ortakut te Vetem eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise, i cili ka te drejte te marre vendime ne lidhje me te gjitha çeshtjet e veprimtarise se saj.

8.2 Asambleja perbehet vetem nga Ortaku i Vetem i Shoqerise.

8.3 Asambleja e Ortakut te Vetem ka te drejte te vendose per: (a) Percaktimin e parimeve te pergjithshme te rregullave te brendshme te Shoqerise; (b) Ndryshimet dhe modifikimet ne Statut; (c) Caktimin dhe shkarkimin e Administratoreve; (d) Caktimin dhe shkarkimin e auditoreve te pavarur dhe likuidatoreve; (e) Caktimin e shperblimit te personave te permendur ne pikat (c) dhe (d); (f) Monitorimin dhe mbikeqyrjen e zbatimit te rregullave te brendshme nga Administratoret, perfshire pergatitjen e bilanceve dhe raporteve vjetore; (g) Miratimin e bilancit dhe raporteve vjetore; (h) Zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit themeltar; (i) Ndarjen e kuotave ne pjese dhe anulimin e kuotave; (j) Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedura te tjera kunder Administratoreve; (k) Ristrukturimin dhe prishjen e Shoqerise.

8.4 Ne çdo rast, Asambleja e Ortakut te Vetem ka te drejte te marre vendime per çdo çeshtje qe tejkalon aktivitetin tregtar te perditshem te Shoqerise.

## **Neni 9**

### **Regjistri i vendimeve te Asamblese se Ortakut te Vetem**

9.1 Vendimet e Asamblese se Ortakut te Vetem duhet te regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen. Administratori ose administratoret e Shoqerise jane pergjegjes per mbajtjen dhe ruajtjen e ketij regjistri.

## **Neni 10**

### **Administrimi i Shoqerise**

10.1 Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume administratore.

10.2 Administratoret kane te drejte te perfaqesojne Shoqerine ne menyre te plote per administrimin e zakonshem te saj, si dhe te drejten per te miratuar te gjitha vendimet qe i gjykojne te pershtatshme per te arritur dhe permbushur qellimin e shoqerise, me perjashtim te vendimeve qe me ligj i takojne Asamblese se Ortakut te Vetem.

10.3 Administratori/et mund te autorizojë/ne pale te treta per ta/t'i perfaqesuar ate/a ne transaksione te veçanta.

10.4 Administratori/et organizon dhe drejton te gjithë aktivitetin tregtar te Shoqerise. Ai eshte i autorizuar te perfaqesojë Shoqerine ne çdo çështje qe lidhet me te ne menyre te drejtperdrejte apo jo te drejtperdrejte.

10.5 Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit/eve jane ato te percaktuara ne ligj, ne kete Statut, nga vendimet e Asamblese se Ortakut te Vetem dhe rregullat e brendshme te administrimit te Shoqerise.

10.6 Administratori i Shoqerise mund te shkarkohet nga pozicioni qe ka ne Shoqeri ne çdo kohe, me vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem.

10.7 Administratorja e Shoqerise eshte znj. Elda Subashi, e identifikuar me dokumentin identifikues nr. BF1560624 dhe nr. personal I85219049U, dhe me zotesi te plote per te vepruar, e cila do te mbaje kete detyre per nje afat 2 (dy) vjeçar nga data e themelimit te shoqerise.

## **Neni 11** **Viti financiar**

11.1 Viti financiar i Shoqerise perkon me vitin kalendarik, fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e tridhjetë e nje te muajit Dhjetor.

11.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar i Shoqerise fillon ne datën e regjistrimit te Shoqerise dhe mbaron ne datën 31 Dhjetor 2024.

## **Neni 12** **Bilanci i Shoqerise, Kontabiliteti**

12.1 Bilanci vjetor i Shoqerise, shqyrtohet nga Asambleja e Ortakut te Vetem dhe do te pergatitet per dorezim prane institucioneve tatimore perpara fundit te muajit Mars te vitit pasardhes.

12.2 Librat kontabel do te mbahen ne gjuhen shqipe dhe ne monedhen vendase (LEK).

12.3 Shoqeria mund te marre financim nga institute financiare qe operojne ne Shqiperi apo jashte saj. Per kete arsye Shoqeria mund te vendose pjese te kapitalit si garanci, ose mund te bjere dakord te hipotekoje pasuri te saj te paluajtshme me vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem.

## **Neni 13** **Likuidimi**

13.1 Asambleja e Ortakut te Vetem mund te vendose mbylljen e Shoqerise.

13.2 Me vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem do te caktohet nje likuidator ose disa likuidatore te cilet do te ndjekin procedurat e likuidimit.

13.3 Likuidatori(et) do te pergatise/in nje raport likuidimi, i cili do te permbaje nje pasqyre te gjendjes ekonomike te shoqerise, hapat e likuidimit dhe kohen e kerkuar per mbylljen e saj. Ne perfundim te procesit, Asambleja e Ortakut te Vetem do te analizoje bilancin permbylles dhe do te miratoje perfundimin e procesit te likuidimit.

**Neni 14**  
**Dispozita Perfundimtare**

14.1 Ky Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, secila prej tyre me te njejten vlere ligjore.

**ORTAKU I VETEM**  
**Elda Subashi**

